

VENDIM
Nr. 54, datë 17.2.2026

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 304, DATË 17.11.2025, “MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË ‘PROINFINIT CONSULTING’ SHPK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 450/1 prot., datë 13.2.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të Bordit nr. 304, datë 17.11.2025”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 6.6.2023, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 6.6.2023.

- Me shkresën nr. 2796 prot., datë 5.11.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion në lidhje me marrjen e autorizimit nga ERE për miratimin e ndryshimit të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 304, datë 17.11.2025, vendosi të japë autorizimin për ndryshimin e ortakëve që kontrollojnë interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. Ortakët e shoqërisë ndryshojnë dhe bëhen Z. A G dhe Z. E K, ku Z. A G bëhet ortaku kryesor që kontrollon interesat e saj (me 65% të kuotave të kapitalit).

- Në vijim, shoqëria, me shkresën nr. 450 prot., datë 2.2.2026, ka paraqitur kërkesën për shfuqizimin e vendimit nr. 304/2025, duke sqaruar se kuotat nuk janë transferuar te Z. A G dhe Z. E K, për arsye të prishjes së marrëveshjes së shitblerjes mes palëve.

- Nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë rezulton se nuk është bërë asnjë kalim/ndryshim kuotash, çka përputhet me sa deklaruar nga shoqëria se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në vijim të vendimit 304/2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 304, datë 17.11.2025, “Mbi dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut, që kontrollon interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti